



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "DAAKONN shpk" të datës 04.02.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet-Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-40-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "DAAKONN shpk" të datës 04.02.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet-Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-40-5-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "DAAKONN SHPK" (tutje "parashtruesi") me datë 04.02.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Largimi, trajtimi dhe deponimi i materialeve të rrezikshme në Kryeqytet-Ritender" me nr. të prokurimit 616-26-40-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtresit janë cituar si në vijim:

j1. Kërkesa për certifikimin ISO IEC 17025

Ju drejtohem me këtë kërkesë për rishqyrtim dhe korrigjim të disa kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit, konkretisht në seksionin e kritereve teknike dhe profesionale, si vijon:

1. Kërkesa për certifikimin ISO IEC 17025

Në pikën 3 kërkohet që Operatorët Ekonomik të posedojnë dhe të prezantojnë certifikatat:

- EN ISO 9001

- EN ISO 14001

- BS ISO 45001

- **ISO IEC 17025**

Kërkojmë që kërkesa për **ISO IEC 17025** të largohet nga dosja e tenderit, pasi kjo certifikatë është e dedikuar për laboratorë testues dhe kalibrues dhe zakonisht nuk posedohen nga operatorë ekonomikë që kryejnë shërbime operative të largimit, trajtimit dhe depozimit të materialeve të rrezikshme.

Vendosja e kësaj kërkesë është joproporcionale me natyrën e kontratës dhe krijon kufizim të pajustificuar të konkurrencës, në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit sipas Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores Nr. 002/2024.

2. Kërkesa për skelistë – pika 7

Në pikën 7 kërkohet:

Katër (4) skelistë, të dëshmohen me kopje të diplomës së shkollës së mesme dhe trajnim të nevojshëm për skelist.

Kërkojmë që kjo kërkesë të rishikohet dhe të sqarohet, pasi profili i skelistit zakonisht dëshmohet përmes certifikatave të trajnimit profesional dhe përvojës praktike, ndërsa diploma e shkollës së mesme nuk është domosdoshmërisht e lidhur drejtpërdrejt me këtë profil pune dhe mund të kufizojë në mënyrë të pajustificuar pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomik.

Shpresojmë që Autoriteti Kontraktues do t'i rishqyrtojë kërkesat tona dhe do të ndërmarrë masat korrigjuese të nevojshme brenda afateve ligjore, në mënyrë që të shmanget nevoja për iniciimin e procedurave të mëtejme ligjore me ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Lidhur me pretendimet ankimore, pas analizimit me kujdes të kërkesave përkatëse të DT në kuptim të nenit 28 dhe nenit 29 lidhur me nenin 7 të LPP, është konstatuar se kërkesat e tilla nuk janë të domosdoshme. Prandaj pretendimet janë gjetur si të bazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtresi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 09.02.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.